



BORN

Borderless Nature

Biodiversity Protection and Development

DOKUMENT STRATEGJIK RRJETI EKOLOGJIK NDËRKUFITAR



Projekti i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Implementuar nga:



Trentino con il Kosovo



BorN - Borderless Nature


BORN – Natyrë pa kufij. Mbrojtja dhe Zhvillimi i Biodiversitetit të parqeve
Natyrale, Bjeshkët e Nemuna dhe Prokljetije.

"Ky publikim është prodhuar me ndihmën e Zyrës së
Bashkimit Evropian në Kosovë. Përmbytja e këtij publikimi
është përgjegjësi e vetme e Trentino con il Kossovo dhe në
asnjë mënyrë nuk pasqyron pikëpamjet e Zyrës së Bashkimit
Evropian në Kosovë."



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Implementuar nga:



Trentino con il Kossovo




Përmbajtja.

Përmbajtja.....	2
Hyrje.....	3
Rreth projektit BorN?.....	3
Çfarë është një rrjet ekologjik.....	3
Rrjeti ekologjik ndërkufitar Kosovë - Mali i Zi	4



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Implementuar nga:



Trentino con il Kosovo



RRJETI EKOLOGJIK NDËRKUFITAR

Hyrje

Ky dokument është redaktuar me qëllim të përshkrimit në mënyrë sintetike të strukturës, të përfundimeve dhe nevojave të menaxhimit të rrjetit ekologjik ndërkufitar Kosovë-Mal i Zi, i cili është identifikuar në kuadër të projektit BORN (Natyre Pa Kufij. Mbrojtja dhe zhvillimi i biodiversitetit në parqet natyrore Prokletije dhe Bjeshkët e Nemuna).

Rreth projektit BorN?

Qëllimi i përgjithshëm i projektit BORN - BORDERless Nature. Natyrë pa kufij. Mbrojtja dhe Zhvillimi i Biodiversitetit të parqeve Nacionale Bjeshkët e Nemuna dhe Prokletije, është, mbrojtja dhe përmirësimi i biodiversitetit në zonat e projektit dhe në veçanti në Parqet Nacionale Bjeshkët e Nemuna (Kosovë) dhe Prokletije (Mal të Zi), duke nxitur zhvillimin e qëndrueshëm socio-ekonomik nëpërmjet bashkëpunimit ndërkufitar në mes institucioneve, Organizatave të Shoqërisë Civile dhe popullsisë, pasi që biodiversiteti si në Kosovë ashtu edhe në Mal të Zi është në rrezik, për shkak të aktiviteteve të paligjshme të tregtisë së drurit, përdorimit të tepruar të specieve bimore medicinale dhe zhvillimit të pakontrolluar gjatë konfliktit të viteve e 90-a, si, prerjet, zjarret/djegjet, dhe ndërtimet e paligjshme edhe në ditët e sotme.


Çfarë është një rrjet ekologjik

Një rrjet ekologjik është një sistem ndërlidhjeje i vendqëndrimeve (habitat) i cili ka për qëllim ka mbrojtjen e biodiversitetit në një zonë gjeografike. Një rrjet ekologjik ka si qëllim edhe ruajtjen, forcimin dhe krijimin e një sistemi të lidhjes dhe shkëmbimit në mes zonave dhe elementeve natyrore të izoluara, duke e luftuar në këtë mënyrë fragmentimin dhe efektet negative mbi biodiversitetin.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë

Implementuar nga:



Trentino con il Kosovo



Një rrjet ekologjik përbëhet nga elemente të ndryshme si:

- **Zona qendrore:** zona me natyrë të shumtë të cilat janë, apo mund të jenë, të mbrojtura në cilësinë e parqeve apo rezervateve;
- **Hapësira zonale:** të vendosura përreth zonave qendrore për ta mbrojtur integritetin;
- **Korridoret e lidhjes:** struktura lineare të cilat lidhin zonat qendrore mes tyre dhe me territorin përreth, duke përfaqësuar elementin kryesor të rrjeteve ekologjike, të cilat po ashtu mundësojnë lëvizjen e specieve;
- **Zona mbledhjeje:** zona të vogla të cilat pranojnë specie në transit apo ku krijohen mikro-ambiente të veçanta;
- **Zona të restaurimit ambientat:** të cilat duhet të jenë zona të intervenimeve aktive për rigjenerim ambientat dhe rindërtim të funksioneve ekologjike.

Rrjeti ekologjik ndërkufitar Kosovë - Mali i Zi

BORN është një projekt i bashkërendimit ndërkufitar në mes Kosovës dhe Malit të Zi për menaxhimin e zonave të mbrojtura dhe zhvillimin ekonomik në sektorët agro-bujqësor dhe të turizmit, ku përfshihen subjekte institucionale, ekonomike dhe kërkimore/hulumtuese në Kosovë, Mal të Zi dhe Trentino (Itali).

Në kuadër të projektit BORN është proceduar me gjetjen e një rrjeti ekologjik ndërkufitar, të fokusuar në dy zonat e mbrojtura në Prokletije në Mal të Zi dhe Bjeshkët e Nemuna në Kosovë. Ky rrjet ekologjik ndërkufitar është zhvilluar sipas mënyrës “poshtë-lartë” falë bashkëpunimit aktiv në mes grupeve të interesit në Kosovë dhe Mal të Zi të cilët kanë filluar një proces të ashtuquajtur “projektim me pjesëmarrje”, duke i dhënë po ashtu vlerë shoqërore këtij rrjeti.

Cilat janë objektivat e propozuara nga rrjeti ekologjik ndërkufitar

Rrjeti ekologjik ndërkufitar propozon:

- Ruajtjen dhe rritjen, për aq sa është e mundur, të trashëgimisë së biodiversitetit në kuadër të habitateve, shtazëve dhe vegjetacionit, të cilat e karakterizojnë zonën kufitare në mes Kosovës dhe Malit të Zi;
- Rritjen e njohurive shkencore, mbi distriktin gjeografik në të cilin ajo zhvillohet, përmes mbledhjes sistematike të të dhënave dhe arkivimit të tyre;
- Rritjen dhe mbështetjen e të gjitha aktiviteteve shoqërore dhe ekonomike të cilat janë në ekuilibër me ambientin natyror: bujqësi, blegtori, artizanat dhe turizëm të qëndrueshëm;
- Favorizimin e shfrytëzimit shoqëror të të mirave natyrore;
- Rritjen e nivelit të vetëdijesimit të komuniteteve lokale lidhur me rëndësinë dhe vlerën e ambientit natyror në të cilin jetojnë;
- Përmirësimin e gjendjes në rast të degradimit ambientat.

Implementuar nga:



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Trentino con il Kosovo



Cilat janë elementet të cilat përbëjnë rrjetin ekologjik ndërkufitar

Rrjeti ekologjik ndërkufitar përbëhet nga këto elemente:

- **Zonat qendrore:** të cilat janë të paraqitura në territoret e dy parqeve kombëtare, Bjeshkët e Nemuna (Kosovë) dhe Prokletije (Mal i Zi);
- **Pikat e një rëndësie të veçantë:** në kuadër të dy parqeve kombëtare dhe të zonave përreth janë përcaktuar disa zona të një vlere të madhe ku ka shtim të specieve të shtazëve dhe të vegjetacionit. Këto pika përfaqësohen nga:
 - **Livadhe malore;**
 - **Zona të livadheve me luginë;**
 - **Formacione pyjore gështenjash** (*Castanea sativa*);
 - **Rrëke uji** të karakterizuara nga një shkallë e ngritur e cilësisë dhe natyrës së ujit;
 - **Shpella.**

Përveç dy kategorive të fundit, të gjitha tipologjitë e tjera të pikave me rëndësi të veçantë përbëhen nga habitate gjysmë-natyrore, ekzistenca e të cilave varet nga aktiviteti i njeriut, si, bujqësia, blegtoaria, pylltaria, të cilat kanë vendosur një ekuilibër të çmueshëm me ambientin natyror;

Një kategori e veçantë e pikave me rëndësi të veçantë është edhe përcaktimi në brendësi të qytetit të Pejës e cila përputhet me disa nga zonat kryesore të gjelbra të zonave urbane, dhe e njëjta është në lidhje të drejtpërdrejtë me korridorin ekologjik të përfaqësuar nga rrjedha e lumit Lumbardhi i Pejës.

- **Korridoret e lidhjes:** janë të ashtuquajturat “korridore ekologjike” të cilat mundësojnë lidhjen në mes zonave qendrore të territorit përreth. Ato kanë një rëndësi të veçantë, sidomos në Rrafshin e Dukagjinit në Kosovë. Këto korridore të lidhjes janë të dy llojeve:
- **Korridore ekologjike lineare,** të karakterizuara nga rrëke uji dhe të kufizuara nga fasha të vegjetacionit;
- **Korridore ekologjike në formë mozaiku,** të formuara nga fasha të gjëra fshatrash, nga fusha dhe kullosa të pasura me element ambiental natyror dhe me florë dhe faunë si dhe gardhe, lisa, pyje, rrëke uji, mure me gurë, etj.
- **Zona të restaurimit ambiental,** të cilat si rezultat i pranisë së aktiviteteve ekonomike apo frekuentimit të lartë të turistëve shndërrohen në burime ndotjeje dhe degradimi ambiental.
- **Elemente të shpërndarjes ambientale,** të karakterizuara nga vizita të cilat konkretizohen


Si do të menaxhohet rrjeti ekologjik ndërkufitar

Më poshtë janë të shënuara të gjitha elementet e qëndrueshme dhe të dobëta të cilat karakterizojnë rrjetin ekologjik ndërkufitar, si dhe mënyrat përmes së cilave rritet qëndrueshmëria dhe shmangen dobësitë. Këto elemente dalin në pah falë analizës SWOT (S – Qëndrueshmëria; W – Dobësitë; O – Mundësitë; T – Rreziqet), të realizuar nga grupe të interesit të Kosovës dhe Malit të Zi.



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë


Implementuar nga:



Trentino con il Kosovo



Elementet pozitive	Si t'i rrisim
Brenda rrjetit	
Nivel i ngritur i biodiversitetit	Duhet të përdoret një politikë e konservimit aktiv dhe pasiv të numrit të shumëllojshëm të specieve të shtazëve dhe vegjetacionit të cilat e bëjnë unik këtë territor.
Prania e llojeve të rrezikuara të faunës, siç është rrëqebulli ballkanik (<i>Lynx lynx balcanica</i>), të ariut të murrmë (<i>Ursus arctos arctos</i>) dhe të ujkut euro-aziatik (<i>Canis lupus lupus</i>)	Në territorin e rrjetit janë të pranishme popullsi, të vogla po të rëndësishme të këtyre specieve me vlera të larta shkencore dhe të konservimit, të cilave do duhet t'i jepet një rëndësi e veçantë në mënyrë që të njëjtat të mbrohet dhe të shumohen.
Prani e bimëve shëruese	Në mesin e bimëve të shumta ka edhe bimë kuruese nga të cilat është e mundur përgatitja e përbërësve mjekësore nga bimët. Bëhet fjalë për një resurs të çmuar i cili mëton vëmendje të veçantë.
Peizazhe dhe monumente natyrore	Peizazhi i vargmaleve të cilat kufizojnë kufirin mes Kosovës dhe Malit të Zi ka një vlerë absolute, siç janë edhe shumë elemente të tjera natyrore të cilat i karakterizojnë ato, si: shpella, ujëvara dhe rrëqe uji, liqene malore dhe fund-grykore, lisa etj. Bëhet fjalë për emergjenca natyrore të cilat, falë edhe rritjes së kujdesshme, mund të shndërrohen në pika për vizita didaktike dhe/apo rekreative, dhe si rezultat edhe në burim financimi për komunitetet lokale.
Resurset ujore	Pasuria e madhe e ujit e cila i karakterizon malet në mes Kosovës dhe Malit të Zi mund të shndërrohet në burim të rëndësishëm resursesh për komunitetet lokale, nëse shfrytëzohet në mënyrë kujdesshme. Liqenet, burimet dhe lumenjt i japin jetë peizazhit të bukur dhe me vlerë të madhe natyrore. Pasuria me ujë furnizon edhe rrjetet e kanaleve për ujitje të fushave bujqësore me fund-gryka dhe rrafshina. Edhe këto rrugë ujore meritojnë vëmendje, jo vetëm për shkak të rëndësisë bujqësore, por edhe si përfaqësues të habitateve të çmuara të shumë specieve të shtazëve dhe vegjetacionit.
Parqet kombëtare	Ekzistimi i dy parqeve kombëtare Bjeshkët e Nemuna, në Kosovë, dhe Prokletije, në Mal të Zi, lehtëson realizimin e politikave për mbrojtjen e ambientit dhe zhvillimit të qëndrueshëm.
Mundësitë e krijimit të korridoreve në mes Kosovës dhe Malit të Zi	Prania e një territori me një vlerë të lartë natyrore, në afërsi të kufijve që i ndan tri vendet, mund të paraqesë një pretekst drejt një dialogu të bashkërenduar për finalizimin e zhvillimit të politikave mbrojtëse të natyrës dhe të një zhvillimi të qëndrueshëm.



Rripi i Gjelbër Evropian	Rripi i Gjelbër Evropian është një korridor natyror ndërkufitar i cili e përcjellë të ashtuquajturën “perde të hekurt”, që nga gadishulli Skandinav në verë, deri në jug në Ballkan. Rripi i Gjelbër Evropian mëton konservimin e natyrës dhe një zhvillim të qëndrueshëm nga një pikëshikim ndërkombëtar, përmes harmonizimit të aktiviteteve njerëzore me ambientin natyror si dhe rritjen e mundësive të zhvillimit socio-ekonomik të komuniteteve lokale. Fryma me të cilën është zhvilluar koncepti i Rripit të Gjelbër Evropian nën moton “Kufijtë ndajnë, kurse natyra bashkon”, përputhet me konceptin e projektit BORN, sidomos kur një nga rrugët Ballkanase të Rripit të Gjelbër Evropian ndjek kufirin në mes Kosovës, Malit të Zi dhe Shqipërisë. Duket qartë, se rrjeti ekologjik ndërkufitar përfaqëson në mënyrën më të mirë, mbivendosjen konkrete të koncepteve të cilat përbëjnë bazën e Rripit të Gjelbër Evropian, dhe si i tillë duhet të përputhet me realitetet e tjera të cilat bëhen pjesë e Rripit të Gjelbër Evropian.
Ligjet ambientale	Territori i rrjetit mund të shndërrohet në një zonë të privilegjuar në të cilën mund të eksperimentohet aplikimi i ligjeve ambientale të kodifikuara në legjislacionet e Kosovës dhe Malit të Zi.
Mungesa e infrastrukturës	Mungesa e infrastrukturës së rëndësishme në pjesën më të madhe të territorit të rrjetit, dëshmon shkallën e lartë të ambientit të egër. Ajo që në shikim të parë do mund të dukej një handikap për territorin, mund të shndërrohet në një avantazh të zhvillimit të turizmit të gjelbër.
Jashtë rrjetit	
Sigurimi i fondeve	Ekzistimi i rrjetit dhe i nevojave të menaxhimit mund të përbëjë mundësi për të pasur qasje në financime specifike, si në nivel kombëtar po ashtu në atë ndërkombëtar.
Fuqizimi i Organizatave Jo - Qeveritare	Një menaxhim i duhur i rrjetit bëhet përmes bashkëpunimit në mes institucioneve publike dhe OJQ-ve të cilat veprojnë në territor. Rëndësia e rolit të OJQ-ve përbën një faktor të rëndësishëm të rritjes së vetëdijes së tyre lidhur me kapacitetet dhe mundësitë.
Vetëdijesimi i banorëve lokal	Vetëdija që komunitetet lokale kanë rreth vlerave të rëndësishme që ka territori në të cilin ata jetojnë përfaqëson një të ashtuquajtur “e mirë jo materiale” e cila duhet të zhvillohet. Rrjeti, megjithatë, mund të zhvillohet më së miri vetëm përmes pranimit të plotë nga ana e banorëve.
Fushata e vetëdijesimit	Rrjeti duhet të shndërrohet në një mundësi reale për të zhvilluar fushata të vetëdijesimit ndaj mbrojtjes së natyrës, zhvillimit të qëndrueshëm shoqëror dhe ekonomik, i drejtuar nga institucionet publike dhe private.



Edukimi ambiental në shkolla	Gjeneratat e reja përfaqësojnë elementin kryesor mbi të cilin duhet investuar për të arritur ruajtjen e natyrës në pikëpamje afatgjate. Rrjeti, habitatet, bimët dhe shtazët të cilat e përbëjnë mund të shndërrohen në pretekste të çmueshme për realizimin e projekteve didaktike dhe ambientale, të cilat duhet të futen në mënyrë organike në plan-programet shkollore.
Harmonizimi i legjislacioneve kombëtare me politikat evropiane	Nevojë për të zbatuar një menaxhim të mirë të rrjetit edhe përmes etapave me realitete të tjera të njëjta. Kjo përballje mund të ofrojë një rast për të aplikuar konkretisht, në territorin kombëtar, politikat evropiane në kuadër të mbrojtjes së natyrës.
“Korridoret e gjelbra”	Territori i rrjetit nuk përfshinë shumën e përgjithshme të zonave të interesit ambiental, ngaqë edhe jashtë saj janë të pranishme ambiente natyrore të një rëndësie të veçantë. Zonat në të cilat gjinden këto ambiente janë të lidhura me rrjetin përmes gjetjes së korridoreve të përshtatshme të lidhjes (korridoret e gjelbra). Këto korridore lidhjeje kanë një rëndësi të madhe në mirëmbajtjen e depërtueshmërisë ekologjike të territorit dhe duhet të jenë objekt i një vëmendje të veçantë në fazën e planifikimit urbanistik, në mënyrë që të shmangen zgjerimet e qendrave të banuara, ndërtimit të rrugëve të reja të lidhjes dhe shumimit të kultivimeve bujqësore të cilat mund të tjetërsojnë këto karakteristika.
Menaxhimi i mbeturinave	Menaxhimi dhe përpunimi i mbeturinave të krijuara nga aktiviteti njerëzor duhet të kenë një vëmendje të veçantë. Këtu duhet të zbatohen praktikatat më moderne për eliminimin e tyre, duke tentuar kufizimin sa më shumë që të jetë e mundur, të prodhimit të mbeturinave, dhe nga ana tjetër duke promovuar klasifikimin e mbeturinave, mbledhjen e energjisë dhe materialeve (të rëndësishme dhe jo të rëndësishme) dhe riciklimit në mënyrë që të shmanget sa më shumë hedhja e mbeturinave në pika grumbulluese.
Zhvillimi ekonomik lokal	Rrjeti duhet të shndërrohet në një laborator të cilit i jepet përparësi që ku do të eksperimentohen format shpikjeje në puqje mes dy E-jave të mëdha (Ekonomi dhe Ekologji). Rrjeti donë të tregojë se si zhvillimi shoqëror, por mbi të gjitha ai ekonomik dhe mbrojtja e natyrës, nuk janë koncepte kundërtëse. Përkundrazi, një zhvillim socio-ekonomik i qëndrueshëm është plotësisht në përputhje me konservimin e natyrës. Për të arritur një rezultat të tillë, në rrjet, duhet t'u jepet përparësi aktiviteteve të eko-turizmit, turizmit rural, promovimit të prodhimeve lokale dhe natyrore. Territori i rrjetit, në të vërtetë, posedon një sërë të mundësive të cilat duhet të shprehen në mënyrën më të duhur. Për të arritur këtë rezultat është i nevojshëm një planifikim dhe zbatim i kujdesshëm i politikave ekonomike lokale, dhe të njëjtat duhet të ndahen në mesin e komunitetit në rrjetin në të cilin ata jetojnë.

Implementuar nga:



Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Trentino con il Kosovo



Ambientet e vetë- qëndrueshmërisë

ELEMENTET NEGATIVE		Si t'i neutralizojmë
Brenda rrjetit		
Mbeturinat	Problemi i hedhjes së mbeturinave në ambient, i cili vërehet në sytë e vizituesve të rrjetit, duhet të trajtohet dhe zgjidhet. Këtu duhet të kemi parasysh mbledhjen dhe menaxhimin e këtyre mbeturinave në mënyrë që një sjellje e tillë, gjegjësisht hedhja e mbeturinave, të mos vijë nga banorët lokal dhe as nga vizituesit. Një vëmendje e veçantë duhet t'i kushtohet pikave ku janë të vendosura lokalet aktuale publike, ku edhe fenomeni i hedhjes është më i madh.	
Trajtimi jo i duhur i ujërave të zeza	Në kuadër të trajtimit të mbeturinave një vëmendje e veçantë i jepet pjesëve të ndotura në fund-gryka të rrjedhave ujore, ku janë të pranishme burime të ndryshme ndotjeje të cilat e dëmtojnë cilësinë e ujit, i cili përndryshe do të mund të ishte i një cilësie të shkëlqyer.	
Menaxhim joefikas i zonave të mbrojtura	Personeli i ngarkuar me menaxhimin e zonave të mbrojtura nuk disponon, së paku sot, të gjitha kompetencat e nevojshme për të zhvilluar në mënyrën më të mirë një aktivitet të ndjeshëm e cila fillon nga vëzhgimi i territorit gjer tek gjuetia pa leje, prerja ilegale e drunjve, nga shoqërimi i vizituesve gjer tek dhënia e mësimave mbi natyrën, nga monitorimi i faunës gjer tek kontrolli i florës. Për të shmangur këto mungesa është e nevojshme të parashikohet realizimi i kurseve dhe aktiviteteve të trajnimit profesional.	
Dallimet në mes enteve lokale dhe qeverisë qendrore	Ekzistimi i vizioneve të ndryshme dhe mbivendosja e kompetencave janë shkaktare të keqkuptimeve dhe problemeve të cilat pengojnë zbatimin e një menaxhimi të duhur të territorit të rrjetit. Është e nevojshme që këto dallime të tejkalohen në baza konstruktive nga ana e subjekteve të përfshira.	
Mungesa e një vizioni strategjik	Një menaxhim korrekt i rrjetit bazohet patjetër në ekzistimin e një vizioni afatgjatë në kohë dhe hapësirë (ndërkufitar) i cili paraqet parimet sipas së cilave duhet të inspirohen politikat e mbrojtjes së natyrës dhe zhvillimit të qëndrueshëm socio-ekonomik. Për të shmangur këtë mungesë është i nevojshëm zhvillimi i planeve dhe dokumenteve strategjike.	



Ndërtime ilegale dhe mungesë e planifikimit urbanistik	Ndërtimi dhe ndryshimi i ndërtimeve, jashtë rregullave dhe normave ligjore, përbën një problem. Zgjidhja mund të kërkohej në një planifikim territorial të ndërtimeve private, sipas normave të qarta dhe të përcaktuara përmes së cilave shmanget “anarkia në ndërtim”, si dhe të bëhet vëzhgimi dhe ndalimi i ndërtimeve abuzive. Mund të jetë i duhur edhe realizimi, pr të mirën e projektuesve, i një lloji numëratoreje ndërtimesh për të shmangur kështu realizimin e ndërtimeve joharmonike.
Gjuetia pa leje	Vrasja ilegale e shtazëve është një praktikë dëmtuese për konservimin e biodiversitetit. Eliminimi i kësaj dukurie mund të shmanget duke rritur vëzhgimin e territorit dhe ndëshkimin e sjelljeve ilegale, por edhe duke promovuar një proces rritjeje graduale të sezonit të gjuetisë lokale.
Shpyllëzim dhe degradim i peizazheve vegetative	Menaxhimi i pyjeve, nëse bëhet në mënyrë të duhur dhe sipas normave të ashtuquajtura “pyllëzim natyror”, nuk bie ndesh me mbrojtjen e biodiversitetit. Gjendja, megjithatë, ndryshon nëse kemi një menaxhim të pyjeve të ndërlidhura vetëm me aspektin ekonomik dhe të finalizuar për të arritur maksimumin e përfitimit nga prerja dhe shitja e drunjve. Në rastin e dytë pasojat negative do të ndihen tek shtazët, vegetacioni dhe peizazhi. Për të shmangur këtë gjendje është i nevojshëm realizimi i kurseve dhe aktiviteteve të profesionalizmit për personelin i cili duhet të merret me menaxhimin e pyjeve, së bashku me një vëzhgim të thukët të territorit për të parandaluar fenomenin e prerjes ilegale të drunjve.
Jashtë rrjetit	
Mungesa e fondeve	Ekzistimi i rrjeteve dhe i masave të saja të menaxhimit duhet të shndërrohen në një shtytje të rëndësishme për të thithur fondet e nevojshme përmes së cilave ato vihen në praktikë.
Mungesa e bashkëpunimeve institucionale	Shiko sa është thënë më lart rreth dallimeve në mes të enteve lokale dhe qeverisë qendrore.
Mos aplikimi i ligjeve	Përbën një problem i cili ndërlidhet me rritjen kulturore të shoqërisë në përgjithësi, në mënyrë që të kuptohet nevoja reale e respektimit të ligjeve dhe rregulloreve të miratuara për mbrojtje të natyrës. Përveç kësaj, të gjithë ata të cilët janë të shtyrë t'i respektojnë ligjet duhet të informohen mbi rëndësinë e respektimit të normave të cilat mbrojnë natyrën.

Implementuar nga:




Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Trentino con il Kosovo



Zhvillimi i energjisë hidroelektrike	Energjia hidroelektrike bie në domen e formave të energjisë së ripërtërishme dhe “të pastër” dhe si rezultat i kësaj edhe shfrytëzohet. Megjithatë, realizimi i impianteve hidroelektrike, edhe në dimensione modeste, mund t’i shkaktojë dëme të përhershme ekosistemeve ujore. Ky reflektim ndërlidhet sidomos me rastin e territorit të rrjetit, ku trupat hidrik paraqesin jo vetëm elemente shumë të rëndësishme të trashëgimisë natyrore por përbëjnë edhe atraksione turistike. Kështu që është e mundshme që në impiantet ekzistuese të aplikohen të gjitha procedurat për minimizim dhe kompensim të efekteve negative. Kurse sa i përket impianteve në projektim e sipër do duhej të zhvillohej një vlerësim i thukët i raportit “kosto ambientale-përfitime ekonomike”, që mund të arrihen duke pasur gjithnjë parasysh efektet e pashmangshme negative në rrjedhat e ujit.
Zhdukja e specieve si pasojë e gjuetisë	Nëse zhvillohet sipas metodave moderne dhe ndaj shtazëve të cilat mund ta bartin presionin e sezonit të gjuetisë, atëherë gjuetia nuk është në kundërshtim me konservimin e biodiversitetit. Kurse, gjuetia në formën e “grabitjes” përbën një mënyrë të shfrytëzimit të territorit që është në kundërshti të thellë me një menaxhim të duhur të rrjetit. Një vëzhgim i thukët i territorit për të kundërshtuar gjuetinë pa leje dhe zbatimin, në bashkërendim me fazat e gjuetisë lokale, i modaliteteve të qëndrueshme të përfitimeve nga sezoni i gjuetisë mund të jenë një alternativë për zgjedhjen e këtij problemi.
Rreziku i zhdukjes së specieve të rralla	Territori i rrjetit përmban disa specie të një vlere të veçantë shkencore dhe konservuese të cilat në gjendjen aktuale janë të rralla. Për të mundësuar mbijetesën e tyre është e mundshme realizimi i projekteve të monitorimit të cilat mundësojnë mbledhjen e të dhënave mbi praninë dhe shpërndarjen e këtyre specieve të domosdoshme për të ideuar dhe realizuar plane të mbrojtjes efikase.





Projekt i financuar nga BE-ja dhe i menaxhuar nga
Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë



Trentino con il Kosovo

Implementuar nga:



REKOGRANIČNA EKOLOŠKA MREŽA



LEGJENDA

- 1. Korridori Linear
- 2. Korridori në formë Mozaiku
- 3. Pika e veçantë Pyjore
- 4. Pika e veçantë Livadhore
- 5. Pikat e veçanta të lumenjëve
- 6. Pikat e veçanta të Biodiversitetit jashtë zonës së studimit
- 7. Zona Restauruese
- 8. Përshkrim Didaktik [edukues]
- 9. Pikë e veçantë e Biodiversitetit urban

LEGENDA

- 1. Linearni koridor
- 2. Korridor u oblik mozaika
- 3. Posebne tačke sume
- 4. Posebne tačke livada
- 5. Posebne tačke reke
- 6. Posebne tačke biodiversiteta izvan studije
- 7. Restauracione zone
- 8. Didaktički opis [edukativni]
- 9. Posebna tačka Urbanskog Biodiversiteta